

Njoftim vendimi

Postuar në : 21/06/2023



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga Ina Rama kryesuese, Rezarta Schuetz relatore, Albana Shtylla, Mimoza Tasi, Sokol Çomo anëtarë, shpalli vendimin për çështjen (JR) nr. 5/2021, datë 21.01.2021 që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Albano Çepele kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 317, datë 20.11.2020.

Në përfundim të gjykimit në dhomë këshillimi, trupi gjykues, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, vendosi:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 317, datë 20.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Albano Çepele.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 21.06.2023